



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 545 Akti

Nr. 427 Vendimi
Tiranë, më 29.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari Kryesuese
Lulzim Hamitaj Relator
Genta Tafa (Bungo) Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 28.7.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Denisa Asko, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Denisa Asko, me detyrë prokurore në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 28.7.2021, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Znj. Denisa Asko ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); si dhe pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, znj. Denisa Asko, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Genta Tafa (Bungo).
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe shqyrtoi të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2021, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të po këtij ligji; dhe (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuese e trupit gjykues komisionere Valbona Sanxhaktari. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Denisa Asko, me vendimin nr. 2, datë 21.7.2021, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Komisioni, po në datën 21.7.2021, e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme lidhur me rezultatet dhe për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.
- vii. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet mbi rezultatet e hetimit kryesisht, në afatin e përcaktuar nga Komisioni. Në vijim, në datën 26.7.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, të caktuar në datën 28.7.2021, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Denisa Asko, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.

- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Denisa Asko ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 28.7.2021 u mbyll, për të rifilluar më 29.7.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-JA

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Automjeti tip “Mercedes-Benz” (Daimler Chrysler)

1. Automjeti tip “Daimler Chrysler 168 A170 CDI”, me targa AA ***, është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2013, si dhe në deklaratën *Vetting*. Ka rezultuar se ky automjet është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, të datës 8.4.2013, të nënshkruar midis palës shitëse Y. Ç. dhe palës blerëse subjekti i rivlerësimit, në vlerën 4,250 euro.
2. Në vijim të hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar se automjeti në fjalë është blerë fillimisht nga shtetasi Y. Ç. në shtetin italian, nëpërmjet faturës nr. ***, datë 28.6.2012, kundrejt çmimit 900 euro, si dhe ka rezultuar se është kryer zhdoganimi, kundrejt pagesës në vlerën 34,307 lekë. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin dhe informacionin si vijon:
 - i. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 12.8.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Denisa Asko, ka të regjistruar automjetin tip “Daimler Chrysler 168 A170 CDI”, me targa AA ***, duke bashkëlidhur edhe dosjen e automjetit¹.
 - ii. Faturë shitjeje nr. ***, datë 28.6.2012, me vlerë 900 euro, lëshuar nga shitësjja R. C., me kod fiskal ***.
 - iii. Aktzhdoganimi i datës 2.7.2012, për automjetin tip “Daimler Chrysler 168 A170 CDI”, me targa AA ***, i dërguar nga Italia nga eksportuesi R. C. dhe marrës shtetasi Y. C., në të cilin ka rezultuar edhe pagesa e tarifës doganore prej 34,307 lekësh.
 - iv. AMF-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 28.8.2020, ka konfirmuar mbulimin me sigurim të automjetit në fjalë nga subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga data 4.11.2012.
 - v. Ministria e Drejtësisë², RNSH, me shkresën nr. *** prot., datë 11.8.2020, ka konfirmuar ekzistencën/lidhjen e kontratave të shitblerjes së automjetit në analizë.

Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie

3. Si burim për krijimin e pasurisë në analizë, subjekti ka deklaruar kredi bankare të marrë në datën 15.10.2012, në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 800,000 lekë duke paraqitur kontratën përkatëse³.
4. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni lidhur me këtë burim krijimi ka rezultuar se kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit, në tetor të vitit 2012 dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se kjo shumë nuk është tërhequr prej saj gjatë vitit 2012, por përgjatë vitit 2013, pikërisht kur është blerë automjeti i lartpërmendur. Konkretisht, nga shqyrtimi i llogarisë së kredisë, ka rezultuar se përgjatë periudhës 1.1.2013 – 8.4.2013 (subjekti ka tërhequr shumën totale prej 620,175 lekësh). Pasi janë përlllogaritur edhe

¹Shkresë nr. *** prot., datë 12.8.2020.

²Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2020, nga Ministria e Drejtësisë, bashkëlidhur së cilës gjendet kopje e regjistrimit noterial në të cilën rezultojnë aktet e nënshkruara nga subjekti dhe personat e lidhur me të. Konkretisht, ndër të tjera, në këtë regjistrim janë evidentuar aktet noteriale të nënshkruara nga nëna e subjektit: Kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 2.2.2016; kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 9.8.2013. Komisioni e ka ftuar subjektin përmes pyetësorit nr. 2 të paraqesë aktet noteriale të sipërcituara. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka paraqitur dokumentet e sipërcituara, si dhe ka parashtruar sa vijon: kontratat i referohen shitjes së të njëjtës pasuri, banesës së ndodhur në Maliq në pronësi të gjyshërve të saj dhe pjesëtarëve të familjes sipas certifikatës familjare në atë periudhë, e përfituar nga privatizimi. Në vitin 2004, gjyshi ka ndërruar jetë dhe, për rrjedhojë, pjesa takuese e tij është ndarë midis trashëgimtarëve ligjorë, mes të cilëve edhe znj. Zh. A.. Shitja e kësaj pasurie është kryer në vitin 2013, por blerësi nuk kishte arritur ta regjistronte brenda afateve ligjore në ZVRPP, për këtë arsye, iu kërkua të përsëriste dokumentet në vitin 2016.

³Kontrata e kredisë e datës 15.10.2012, lidhur mes subjektit dhe “Raiffeisen Bank”.

shpenzimet e subjektit, përgjatë së njëjtës periudhë, ka rezultuar se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën prej 117,788 lekësh.

5. Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se automjeti është blerë me të ardhurat e kredisë bankare, pagesa është kryer *cash* dhe se nuk disponon dokumentacion që provon kryerjen e kësaj pagese.
6. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegonte lidhur me dinamikën e njohjes me palën shitëse të mjetit në fjalë, shtetasin Y. C.. Subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë lloj marrëdhënieje apo komunikimi, apo konflikt interesi me këtë shtetas.
7. Lidhur me ekzistencën e mundshme të marrëdhënieve shoqërore apo të ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm të interesave, Komisioni i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shkodër informacion mbi çështje të mundshme të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, me palë ndërgjyqëse shtetasin Y. C.. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 26.6.2021 dhe Prokuroria e Rrethit Shkodër, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 29.6.2021, kanë bërë me dije se për shtetasin e sipërpërmendur, nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nuk ka rezultuar ndonjë hetim i kryer nga këto prokurori. Për rrjedhojë nuk u konstatua ndonjë rrethanë që të ngrinte dyshime mbi konflikt interesi, për sa kohë subjekti nuk ka kryer veprime hetimore ndaj këtij shtetasi.
8. Gjithashtu, lidhur me përdorimin e disa automjeteve nga subjekti i rivlerësimit për udhëtime të ndryshme, siç ka rezultuar nga të dhënat e sistemit *TIMS*, Komisioni, me anë të shkresave nr. *** prot., datë 2.6.2021, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nr. *** prot., datë 2.6.2021, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kërkuar nga këto prokurori që të bënin me dije nëse kishte pasur ndonjë çështje të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, me palë ndonjërin nga pronarët e automjeteve në fjalë⁴. Këto të fundit me shkresat nr. *** prot., datë 24.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 29.6.2021, kanë konfirmuar se nuk kanë rezultuar çështje të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, me palë ndonjërin nga këta shtetas.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e sipërpërshkruara – për të cilat i ish-in kërkuar shpjegime – përveç dokumentacionit të përcjellë pranë Komisionit, ka sqaruar se: “[...] automjeti është blerë me të ardhura nga kredia bankare dhe pagesa është kryer *cash*. Pagesa e kryer konfirmohet edhe nga përmbajtja e kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie vlera e të cilës në lekë, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë të datës 8.4.2013, ka qenë 595,000 lekë (me kursin 140 lekë në vend të 140.21 të përdorur nga Komisioni) ”.
10. Po ashtu, subjekti ka pretenduar rishikimin e analizës financiare duke kërkuar shtimin e të ardhurave nga pensioni i gjyshes dhe uljen e shpenzimit të transportit Tiranë-Shkodër me vlerë 600 lekë vajtje-ardhje në vend të vlerës 800 lekë të përlllogaritur nga Komisioni. Gjithashtu, ka kërkuar të mbahet në konsideratë fakti që analiza e kryer është rezultat i përlllogaritjes së kryer në kushte empirike, duke kryer përlllogaritje të shkëputura vetëm për këtë periudhë kohore, pa marrë për bazë gjendjen faktike përpara/pas kësaj periudhe kohore. Subjekti, po ashtu ka pretenduar se shpenzimet e transportit dhe të qirasë janë pjesë përbërëse edhe të shpenzimeve të jetesës dhe zënë një përqindje përkatësisht 6.8% dhe 10.2% (ku përfshihen të gjitha shpenzimet për banesën – ujë, drita dhe qira).

⁴P. K., Th. L., A. Dh., A. K., L. B., O. R., N. Ç., A. G., E. K., Y. Ç..

Vlerësimi i trupit gjykues

11. Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe pretendimet/prapësimet e subjektit, ripërlloragriti disa zëra të analizës financiare, duke përfshirë aty të ardhurat e provuara lidhur me pensionin e gjyshes së subjektit, përgjatë 3 muajve të vitit 2013. Gjithashtu, është përlloragritur ulja e shpenzimeve të transportit për në vendin e punës, në vlerën 600 lekë/ditë pune. Në përfundim të përlloragritjeve, lidhur me këtë pasuri, duke përdorur kursin e këmbimit mesatar në vlerën 140 ALL/E, rezultati përfundimtar shkoi nga – 117,788 lekë në – 61,532 lekë, sikurse është detajuar në tabelën vijuese.

Fonde të tërhequra 01.01-08.04.2013	620 175
Të ardhura nga pensioni	42 764
Shpenzime 01.01-08.04.2013	- 129 471
Shpenzim për blerjen e automjetit	- 595 000
Rezultati	- 61 532

12. Lidhur me pretendimin për zbritjen nga shpenzimet e jetesës të pjesës që zënë në të shpenzimet e transportit dhe të qirasë, Komisioni vlerëson se shpenzimet e jetesës të përlloragritura nga INSTAT-i janë në vlera mesatare për të gjithë vendin, duke pasqyruar vlera minimale jetike dhe, për këtë shkak, në mungesë të provës së kundërt, nuk mund të prezumohet asgjëkundi një kosto jetese më e ulët, pavarësisht diferencave faktike midis zonave të ndryshme. Kjo për sa kohë edhe aty ku shpenzimet jetike mund të jetë më të ulëta se zonat e tjera, në mungesë të përdorimit të produkteve të vetëprodhuara, niveli real i kostove minimale të jetesës nuk mund të jetë më i ulët se ai i aplikuar/përlloragritur nga Komisioni.
13. Megjithatë, trupi gjykues, nisur nga sa më sipër dhe bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni, çmon se pamjaftueshmëria financiare e konstatuar në këtë rast është në një nivel minimal të papërfillshëm, e cila, e parë edhe në harmoni me rezultatet e tjera në tërësinë e çështjes, si dhe në raport me parimin e proporcionalitetit nuk përbën shkak për aplikimin e ndonjë mase ndaj subjektit të rivlerësimit.

2. Lidhur me llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”

14. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë llogari bankare, në të cilën ka pasur gjendje shumat 74,681 lekë dhe 5 euro. Referuar dokumentacionit të administruar lidhur me lëvizjet bankare të llogarive të subjektit të rivlerësimit është konfirmuar gjendja e kësaj llogarie bankare të subjektit, në përputhje me shumat e deklaruara, si dhe është konfirmuar burimi i krijimit të tyre nga të ardhurat nga pagat.
15. Nga analizimi i lëvizjeve bankare është konstatuar se në llogarinë e subjektit, veç të tjerash, ishin kryer dy depozitime, përkatësisht në shumat 90,000 lekë në datën 13.4.2016, nga nëna e saj, znj. Zh. A., dhe 60,000 lekë në datën 23.9.2016, nga babai i saj, z. M. A..
16. Në lidhje me këto depozita, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se këto shuma i ka marrë nga prindërit në formën e ndihmës dhe dhuratës, me qëllim pagesën e studimeve të motrës së subjektit dhe mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të saj. Ndonëse është pyetur sërish nga Komisioni, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion ku të evidentohet përdorimi i shumave në fjalë nga e motra apo transferimi i këtyre fondeve në llogari të motrës, për sa kohë në përshkrimin e veprimeve bankare nuk evidentohet një gjë e tillë.
17. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti ka përfutur të ardhura nga bashkëpunimi i parashikuar në disa kontrata të lidhura për ushtrimin e veprimtarisë si eksperte ligjore, pranë Institutit për Kërkime dhe Alternativa

Zhvillimi (IDRA), si dhe pranë Institutit të Evropës Juglindore për Kontratën Shoqërore (SSCI).

18. Lidhur me këto aktivitete e të ardhura, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të paraqiste shpjegime dhe dokumentacion ligjor lidhur me pajtueshmërinë e këtij bashkëpunimi, me funksionin që ajo ka kryer njëkohësisht asokohe, si dhe mbi dakordësinë/lejimin nga eprorët/drejtuesit, lidhur me impenjimet e saj për/në këto aktivitete profesionale. Nëpërmjet përgjigjeve të saj, subjekti ka pohuar se ftesa për angazhimin në këtë projekt është iniciuar nga zëvendësministri i Drejtësisë, i asaj kohe, i cili nëpërmjet një komunikimi elektronik⁵ drejtuar stafit të këtij institucioni, ka bërë thirrje për pjesëmarrjen në aktivitetin trajnues dhe, në vijim, me angazhimin si ekspertë në dobinë e vetë institucionit (Ministritë së Drejtësisë). Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se pjesëmarrja në aktivitetin trajnues është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i asaj periudhe në Ministrinë e Drejtësisë dhe se shërbimi i konsulencës ofrohej si shërbim *online* dhe kryhej jashtë orarit zyrtar.
19. Lidhur me lëvizjet bankare, DPPPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 26.8.2020, ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar raportime nga bankat në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Denisa Asko.
20. Trupi gjykues, nisur nga sa më sipër, vlerëson se deklaratimet e subjektit, lidhur me gjendjet në llogarinë e saj bankare, përputhen me dokumentacionin e administruar nga Komisioni, si dhe nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të tyre, për sa kohë kanë rezultuar të përfituara nga burime të ligjshme financiare dhe, konkretisht, nga puna e saj.

3. Lidhur me vendbanimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite

21. Në DIPP-në përpara fillimit të detyrës, në vitin 2009 e në vijim në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se ka banuar në adresat e mëposhtme:
 - i. Apartament në adresën: “Blloku nr. ***, M., Korçë”. Subjekti, në lidhje me këtë apartament, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se kjo është adresa e gjendjes civile në të cilën është regjistruar. Gjithashtu, ka sqaruar se kjo banesë ka qenë në pronësinë e prindërve të saj, e përfutur nëpërmjet privatizimit dhe më pas ata e kanë shitur atë, përpara fillimit të detyrës nga subjekti.
 - ii. Apartament me qira, me adresë në rrugën “K. G.”, nr. ***, Tiranë, në të cilin subjekti ka banuar kundrejt qirasë mujore me vlerë 30,000 lekë. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se prej momentit të marrjes së detyrës ka banuar me gjyshen, shtetasen B. K., në adresën e sipërpërmendur, të marrë me qira nëpërmjet marrëveshjeve verbale mes shtetasës B. K. dhe pronarit të banesës A. G.. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se nuk disponon as dokumentacion në lidhje me pronësinë dhe as dokumentacionin që provon pagesat e qirasë, në lidhje me banesën në fjalë.
 - iii. Apartament me qira, me adresë: rruga “A. V.”, nr. ***, h. ***. Subjekti ka bërë me dije se nga prilli i vitit 2016 e aktualisht, banon në këtë adresë, të cilën e ka marrë me qira kundrejt qirasë mujore prej 30,000 lekësh nëpërmjet marrëveshjes verbale mes gjyshes së saj dhe pronares së banesës, E. K., por nuk është depozituar ndonjë dokumentacion që të provojë pronësinë e këtij të fundit mbi apartamentin apo shumën e qirasë së paguar.
22. Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni, ka deklaruar se qiraja për të dy apartamentet

⁵Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës korrespondencën me e-mail, në lidhje me pjesëmarrjen në këto aktivitete.

në të cilët ka banuar me qira, është paguar *cash* nga gjyshja dhe si burim kanë shërbyer të ardhurat nga pensioni. Ndërkohë, vetë subjekti ka kontribuar në shpenzimet e jetesës së përbashkët, nëpërmjet të ardhurave nga paga e saj si prokurore.

23. Komisioni ka kryer verifikimin *online*, në sistemin multifunksional të ASHK-së, nga ku ka rezultuar se pasuria në adresën “Blloku nr. ***, M., Korçë”, ka rezultuar e shitur në datën 12.2.2004, ndërkohë që nuk kanë rezultuar të regjistruara pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit apo të personave të lidhur me të. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të bënte me dije mbi investime të mundshme të kryera nga anëtarët e familjes së saj dhe/apo nga gjyshja e saj, si dhe mbi të ardhurat e tyre – të cilat kanë përbërë burimet e ligjshme financiare të përdorura për pasuritë/shpenzimet e tyre – duke paraqitur dokumentacionin përkatës ligjor provues. Lidhur me këtë pyetje, subjekti ka deklaruar se nga momenti i fillimit të detyrës deri në datën 15.9.2015, ka qenë pjesë e certifikatës familjare së bashku me prindërit dhe motrën, si dhe ka sqaruar se gjatë kësaj periudhe prindërit, motra dhe gjyshja nuk kanë kryer asnjë investim. Pasi janë kryer verifikimet përkatëse, nëpërmjet sistemit multifunksional të ZRPP/ASHK-së, për shtetasit A. G. dhe E. K., është konfirmuar se në emër të tyre rezultojnë të regjistruara pasuritë e paluajtshme të përshkruara më sipër.
24. Subjekti, pasi është pyetur në lidhje me kontrata të mundshme të furnizimit me ujë/energji elektrike, si dhe pagesat përkatëse, për banesat në fjalë, ka sqaruar se nuk ka lidhur asnjë kontratë furnizimi me ujë/energji elektrike. Gjithashtu, Komisioni e ka pyetur subjektin nëse ka pasur marrëdhënie familjare apo shoqërore me pronarët e këtyre banesave, pyetje së cilës ajo i është përgjigjur duke pohuar se përveç komunikimit normal rastësor me këta shtetas, që prej vitit 2016, kur është larguar nga banesa e shtetasit A. G., nuk ka pasur asnjë komunikim tjetër me këtë shtetas.
25. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar⁶ Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, informacion lidhur me çështje/hetime të mundshme ndaj shtetasve A. G. dhe E. K.. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁸ kanë konfirmuar se nuk ka rezultuar të jenë hetuar çështje me palë shtetasit e sipërcituar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

26. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatin e hetimit administrativ lidhur me këtë pikë, ka shpjeguar se përpara fillimit të detyrës, për arsye ekonomike, ka banuar me gjyshen në banesën e ndodhur në adresën: rruga “K. G.” nr. ***, Tiranë, nga e cila është larguar në muajin prill të vitit 2016, duke mos pasur më asnjë kontakt me pronarin e banesës, shtetasin A. G.. Gjithashtu, subjekti ka pohuar sërish se nuk dispononte dokumentacion në lidhje me pagesat e qirasë, por ka pretenduar se kostoja ka qenë 15,000 lekë/muaj dhe pagesa kryhej *cash* çdo gjashtë muaj. Subjekti ka sqaruar se kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike (të cilat ishin në emër të shtetasit pronar) janë dorëzuar së bashku me çelësat e banesës, në momentin e largimit nga banesa dhe ka paraqitur foto të tyre. Subjekti ka pretenduar se shuma e qirasë për periudhën deri në prill të vitit 2016, ka qenë 15,000 lekë dhe jo 30,000 lekë. Në lidhje me banesën aktuale me

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2021, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe shkresa nr. *** prot., datë 2.6.2021, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2021.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2021.

qira, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.7.2021, të shtetases E. K. në lidhje me marrëdhënien e qirasë në fuqi.

Vlerësimi i trupit gjykues

27. Në lidhje me adresat e vendbanimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentacionin dhe shpjegimet të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arriti në konkluzionin se lidhur me adresën e parë të banimit, kjo pasuri, bazuar edhe në deklaratën noteriale të shtetases E. K., çmon se shpjegimet janë bindëse, për sa kohë është provuar se pronësia e apartamentit me nr. pasurie ***, në z. k. ***, është në pronësi të shtetases së sipërpërmendur, me të cilën ekziston një marrëdhënie qiradhënieje (ende vijuese). Gjithashtu, kjo adresë përputhet me atë të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.
28. Lidhur me adresën e dytë të vendbanimit, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 deri në DIPP-në e vitit 2014, nisur nga dokumentacioni i disponuar rezultoi e provuar se kjo pasuri, në momentin që është përdorur nga subjekti ishte në pronësi të shtetasit A. G., - me nr. pasurie ***, në z. k. *** dhe e privatizuar prej tij në vitin 1994. Për rrjedhojë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me dokumentacionin e disponuar dhe nuk ngrihen dyshime mbi pronësinë e pasurive në fjalë apo për konflikt interesi të subjektit me personat e lartpërmendur.
29. Trupi gjykues, nisur nga sa më sipër, dhe në analizë të materialit të administruar – duke mbajtur në vëmendje pretendimet e subjektit dhe pasi ka vlerësuar arritjen e një niveli bindës të shpjegimeve të tij, ka konkluduar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me vendbanimet e subjektit të rivlerësimit.
30. Komisioni, lidhur me pretendimin se shuma e qirasë ka qenë në vlerën 15,000 lekë, vlerëson se për sa kohë nuk është bërë ndonjë specifikim apo qartësim mbi ndryshimin e vlerave të qirasë së paguar nga subjekti, për periudhën 2009 – 2014 për dy apartamentet e deklaruara si adresa banimi në deklaratën *Vetting*, sikurse ka deklaruar subjekti një shpenzim prej 30,000 lekësh/muaj, pretendimi i saj u mbetet në nivelin e deklaratimit të vonuar, pasi një pretendim/ndryshim deklarimi i tillë nuk është paraqitur më herët, por për herë të parë pas rezultateve të hetimit. Nga sa më sipër, Komisioni ka marrë në konsideratë vlerën e shpenzimit të kryer lidhur me shpenzimin e deklaruar si pagesë të kryer në masën 30,000 lekë, pasi ndonëse pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit mund të ketë qenë 15,000 lekë/muaj, përllogaritja në analizën financiare ka përfshirë edhe shpenzimet jetike dhe të qirasë edhe të gjyshes së subjektit, në cilësinë e personit të lidhur/bashkëjetueses, sikurse janë përllogaritur edhe të ardhurat e kësaj të fundit.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

31. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përllogaritja krahasimore e tyre është konstatuar një mjaftueshmëri e burimeve financiare, për disa vite, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe bilancit të përgjithshëm për periudhën 2009 – 2016 përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar me një vlerë negative prej 647,980 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

32. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka kërkuar rishikimin e përllogaritjes së disa zërave të të ardhurave dhe të shpenzimeve, sipas pretendimeve të

mëposhtme:

- a. Lidhur me të ardhurat, të llogariten të ardhurat e përfituara nga pensioni i gjyshes së subjektit, të ndjerës B. K., sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga ISSH-ja Korçë.
- b. Lidhur me shpenzimet e transportit, subjekti është shprehur se automjeti pas blerjes në prill të vitit 2013 është pajisur me targa në qytetin e Korçës dhe leja e qarkullimit është lëshuar në korrik të vitit 2013. Ndërkohë që shpenzimet për transportin, për në vendin e punës, në qytetin e Shkodrës janë kryer/ndarë së bashku me disa kolegë, për sa kohë janë përdorur automjetet e tyre. Për këtë arsye, sqaron subjekti se automjeti i saj nuk është përdorur për këto udhëtime por është lënë në Korçë, pranë prindërve të saj.
- c. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se pagesat për policat e sigurimit të mjeteve për periudhën 2014 – 2016 janë kryer nga babai dhe, për rrjedhojë, kërkon që ky shpenzim të mos përfshihet në analizë për vitet 2014 – 2016.
- d. Ndërkohë që përgjatë vitit 2013, sipas subjektit, ka udhëtuar për në vendin e punës me mjete të transportit publik dhe, për këtë shkak, shpenzimet e transportit do të duhet të përlllogariten në bazë të tarifës së transportit publik.
- e. Veç sa më lart, subjekti ka kërkuar uljen e shpenzimeve të udhëtimit për biletën e avionit në Gjermani, për të cilën ka pretenduar se shpenzimi në fjalë ka qenë në vlerën 141 euro dhe jo 250 euro, siç është përlllogaritur nga Komisioni – duke paraqitur dokumentacionin përkatës.
- f. Gjithashtu, subjekti ka kërkuar uljen e shpenzimeve të transportit për udhëtimin turistik në Shën Naum, pasi sipas sistemit *TIMS* ka dalë në këmbë dhe ka pretenduar se vijimi për në Shën Naum është bërë në këmbë, duke mos u përlllogaritur kështu shpenzimi për kartonin jeshil.
- g. Po ashtu, është kërkuar ulja e shpenzimeve për udhëtimin turistik në Dubrovnik, pasi për të është marrë/përdorur një ofertë nga një agjenci udhëtimesh dhe bazuar në të dhënat e disa ofertave të aplikuara në periudha të ngjashme e tjera të paraqitura të mëparshme dhe mëpasshme, kostoja e këtij udhëtimi varion në vlerat 89 euro në 109 euro.

Vlerësimi i trupit gjykues

33. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin e paraqitur, vlerëson se një pjesë e shpjegimeve të saj janë bindëse dhe kjo mjafton për të pakësuar ndjeshëm vlerën negative (minimale) të konstatuar nga analiza e përgjithshme financiare e kryer përgjatë hetimit administrativ për vitet 2009 – 2016. Kësisoj, rasti *de quo*, duke mos përbërë shkak të mundshëm për penalizimin e subjektit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, e bën të panevojshëm analizimin e detajuar të secilit pretendim, për sa kohë edhe vetë objekti i tyre qëndron në një nivel të papërfillshëm, në këndvështrimin e impaktit të zërave/pretendimeve në fjalë mbi bilancin e përgjithshëm financiar, që si përfundim rezulton pothuajse pozitiv.

B. KONTROLI I FIGURËS

34. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016,

është përcjellë pranë Komisionit një raport me nr. *** prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Denisa Asko.

35. Në vijim të kërkesës së Komisionit për një përditësim, nga DSIK-ja janë përcjellë disa shkresa përditësuese, konkretisht me data 1, 15 dhe 16 qershor 2021, nëpërmjet të cilave bëhet me dije se edhe për periudhën pas raportit të lartpërmendur nuk disponohen të dhëna mbi përfshirje të mundshme në aktivitete të kundërligjshme për subjektin e rivlerësimit Denisa Asko.
36. Gjithashtu, DSIK-ja i ka bërë me dije Komisionit se raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Denisa Asko, është deklasifikuar plotësisht më 31.5.2021.
37. Për rrjedhojë, në vijim të komunikimeve me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit, lidhur me këtë kriter, që mund të ngrinin dyshime mbi bazueshmërinë e konkluzioneve të arritura nga DSIK-ja – si më lart. Për rrjedhojë, edhe Komisioni e vlerëson të përshtatshëm znj. Denisa Asko për të vijuar detyrën si prokurore.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

38. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Denisa Asko, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja dhe të përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2021; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese – burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLP-ja

39. Në raportin e KLP-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Sektori i Protokoll-Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme.
40. Sipas këtij raporti: (i) subjekti i rivlerësimit, znj. Denisa Asko, ka aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ajo përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale dhe shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të normave të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret për procedimet për të cilat janë ndjekur nga prokurorja. Kështu, menjëherë, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorja Denisa Asko, për vitet 2012, 2013 dhe 2014 të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për aftësitë profesionale

në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”; (ii) nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurorja dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit Denisa Asko shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e tij të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsytimit. Në arsyetimet ligjore prokurorja bën një analizë përveç normave të Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale edhe të ligjeve specifike siç ishte në rastet e ligjit për mbrojtjen e territorit, sigurimeve shoqërore. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e saj bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, provave të mbledhura, provave të paraqitura nga mbrojtja, si edhe kërkesave dhe pretendimeve të mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje; (iii) subjekti i rivlerësimit Denisa Asko kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga subjekti i rivlerësimit, veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi. Nisur nga sa më sipër, konstatohet se vlerësimi i përgjithshëm i kryer nga KLP-ja ka qenë pozitiv.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

41. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP -së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, si dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
42. KLP-ja, në raportin e përcjellë pranë Komisionit, ka bërë me dije se bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, rezultoi se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2019, në të cilin përmendet prokurorja Denisa Asko.
43. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, Komisioni ka konstatuar se shtetasi A. B. ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Përgjithshme kundër shtetasve Denisa Asko, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe ndaj gjyqtarit S. P., gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke i akuzuar për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me pretendimin se kanë hetuar dhe po gjykojnë për herë të dytë një kallëzim penal të hetuar dhe gjykuar më parë. Ky shtetas ka pretenduar se është shkelur parimi universal i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër.
44. Prokuroria e Përgjithshme, duke mos qenë kompetente, ka dërguar aktet e këtij materiali kallëzues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga shqyrtimi i këtij materiali kallëzues ka rezultuar se prokurorja Denisa Asko, duke qenë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka qenë personi kompetent i ngarkuar me ligj për hetimin dhe vendimmarrjen e sipërcituar. Një vendimmarrje e tillë brenda tagrit ligjor dhe kushtetues nuk mund të përbëjë elemente të figurës së veprës penale “shpërdorim të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjithashtu, gjyqtari

S. P., duke qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është personi kompetent për gjykimin e çështjen penale me objekt “ankim kundër vendimit të mosfillimit” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

45. Organi i akuzës nuk mund të hetojë ligjshmërinë e vendimmarrjes apo urdhëresave të një gjykate apo të një prokurori, apo të kontrollojë zbatimin prej saj të procedurave ligjore të ligjit material dhe procedural, përderisa sistemi ynë i së drejtës, kuadri normativ kushtetues dhe ligjor në fuqi, si dhe parimet e procesit të rregullt ligjor vendosin shkallët hierarkike të gjyqësorit si mekanizma kontrolli ndaj gjykatave më të ulëta, duke parashikuar edhe instrumentet ligjore për ndreqjen eventuale të vendimeve gjyqësore. Ky konkluzion bazohet edhe në vendimin nr. 11, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese sipas frymës të së cilit vendimet gjyqësore nuk mund të jenë objekt i ndjekjes penale.
46. Ka rezultuar se më 19.12.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendosi të mosfillojë procedimin penal për materialin me nr. *** , datë 6.12.2019, të kallëzuar nga shtetasi A. B.

DENONCIME NGA PUBLIKU

47. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku dy denoncime, nga i njëjti denoncues, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse dhe ka rezultuar se nga përmbajtja e tyre nuk janë evidentuar prova mbi shkelje të mundshme apo *indicie* mbi të cilat mund të kryhej ndonjë hap hetimor i mëtejshëm nga Komisioni.

1. Denoncimi nr. * prot., datë 7.8.2018 nga shtetasi P. B.**

48. Shtetasi P. B. ka depozituar denoncimin, në të cilin akuzon disa subjekte rivlerësimi e ndërmjet tyre edhe prokuroren Denisa Asko, por nuk ka përshkruar shkelje procedurale specifike. Bashkëlidhur denoncimit ka rezultuar vendimi për mosfillimin e procedimit lidhur me kallëzimin nr. *** , të vitit 2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistruar për veprën penale “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, vendim i cili ka rezultuar i arsyetuar nga një tjetër prokuror.
49. Për rrjedhojë, nuk rezultoi ndonjë provë apo shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit, për më tepër që në këtë rast subjekti as nuk ka qenë e përfshirë në veprime konkrete.

2. Në lidhje me denoncimin në televizionin “Top Channel”

50. Nga televizioni “Top Channel” në linkun <https://top-channel.tv/2019/09/14/rrezohet-akuza-per-manipulim-ne-prokurorine-e-tiranes-739-dosje-per-30-qershorin/> ka rezultuar i publikuar lajmi si vijon: “Organi i akuzës ka vendosur precedentin për të rrëzuar pretendimet e opozitës për manipulimin e procesit të datës 30 qershor. Vendimi i parë është dhënë nga Prokuroria e Tiranës, nga znj. Denisa Asko, e cila ka vendosur mosfillim të çështjes kundër një komisioneri të një partie politike. Në lidhje me konstatimin e sipërcituar, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

51. Subjekti, në prapësimet e sjella, ka shpjeguar se rasti i denoncuar i referohet kallëzimit penal nr. *** , datë 3.9.2019, për të cilin në datën 9.9.2019 është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për shkak se nuk plotësoheshin kriteret ligjore për regjistrimin e procedimit penal dhe fillimin e ndjekjes penale për veprat penale të paraqitura në kallëzim, në bazë të neneve 290/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi është marrë brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 291, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale. Vendimmarrja e mësipërme nuk është ndryshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vlerësimi i trupit gjykues

52. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni është konstatuar se kallëzimi në fjalë është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 3.9.2019, ndërkohë që data e vendimmarrjes ka qenë 9.9.2021. Nga shqyrtimi i vendimit të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës ka rezultuar se subjekti ka arsyetuar se bëhet fjalë për rrethanat e përcaktuara në germën “ç”, të nenit 290, të Kodit të Procedurës Penale, rrethanë e cila parashikon mosfillimin e procedimit penal pasi “... *fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston*”. Në analizë të pikës 2, të nenit 291, të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “... *kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit*”. Nisur nga sa më lart, Komisioni ka konstatuar se vendimmarrja e subjektit ka qenë në respektim të përcaktimit ligjor të sipërcituar.
53. Trupi gjykues, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se shpjegimet e tij kanë rezultuar bindëse dhe se në çështjen në analizë nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit.

3. Në lidhje me lajmin e publikuar në faqen online, abcnews.al

54. Nga faqja *abcnews.al*, në linkun <https://abcnews.al/e-shpetoi-mjeku-asnje-dite-burg-pasi-i-keputi-kemben-te-rese-prokurorja-i-terheq-veshin-gjykates-per-brecanin/>, ka rezultuar se prokurorja Denisa Asko ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për vleftësimin e arrestimit në flagrancë të shtetasit dhe në bazë të nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale për personin ndaj të cilit zhvillohen hetime.
55. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën e paraqitur nga organi i Prokurorisë Tiranë dhe në vijim ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurisë ndaj personit në hetim nga arrest me burg në “arrest shtëpie”.
56. Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime lidhur me sa më sipër është konstatuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

57. Subjekti ka sqaruar se brenda afatit procedural prej 48 orësh të parashikuar nga neni 258 i Kodit të Procedurës Penale është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesa për vleftësimin e arrestimit në flagrancë të shtetasit dhe në bazë të nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale për personin ndaj të cilit zhvillohen hetime. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën e paraqitur nga organi i Prokurorisë, duke vendosur masën e sigurisë.
58. Personi ndaj të cilit zhvillohen hetime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj tij. Në seancën e shqyrtimit të kësaj kërkesë, nga ana e subjektit është kërkuar rrëzimi i kërkesës. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur zëvendësimin e masës, duke i caktuar si masë sigurimi personal “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, për personin ndaj të cilit zhvillohen hetime. Në bazë të nenit 249 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i është drejtuar me ankim Gjykatës së Apelit Tiranë. Seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 25.6.2021 (ditë e premte) dhe në bazë të nenit 249,

paragrafi 1, i Kodit të Procedurës Penale afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës është 5 ditë.

59. Gjykata e Apelit Tiranë, në seancën gjyqësore datë 13.7.2021, referuar kërkesës së paraqitur nga organi i Prokurorisë për heqjen dorë nga ankimi, bazuar në nenin 420/ç të Kodit të Procedurës Penale me vendimin nr. ***, datë 13.7.2021, ka vendosur mospranimin e ankimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

60. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë, përgjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se pranë kësaj gjykate është regjistruar më 7.7.2021 kërkesa për zëvendësim mase sigurimi (neni 231 Kodit të Procedurës Penale). Gjithashtu konstatohet se statusi i shqyrtimit të kësaj çështjeje është në “përpunim”. Në analizë të nenit 249, paragrafi 1, të Kodit të Procedurës Penale konstatohet se nga subjekti është respektuar afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës (5 ditë), sipas përcaktimit ligjor të sipërcituar. Më pas ka rezultuar se Gjykata e Apelit Tiranë në seancën gjyqësore datë 13.7.2021, referuar kërkesës së paraqitur nga organi i prokurorisë për heqjen dorë nga ankimi, bazuar në nenin 420/ç të Kodit të Procedurës Penale me vendimin nr. ***, datë 13.7.2021, ka vendosur mospranimin e ankimit.
61. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar përmbajtjen e denoncimit në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti, trupi gjykues çmon se edhe në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të saj.
62. Trupi gjykues, në këto kushte, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLP-ja, si dhe denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Denisa Asko, ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Denisa Asko:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Komisioni, në këto kushte, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Denisa Asko, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Denisa Asko, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 29.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI

Kryesuese

Lulzim HAMITAJ

Relator

Genta TAFA (BUNGO)

Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi